



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 5674/prot.  
5

Himarë, më 12.12.2023

PROJEKTVENDIM

Nr. 52 datë, 12.12.2023

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË  
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2024

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 57/2020, "Për pyjet",

VENDOSI:

1. Përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, për Bashkinë Himarë, i cili do të jetë 20 punonjës në total. Nga këta 12 punonjës sezonal mirëmbajtje, 3 edukatore kopshti zëvendësuese dhe 5 roje pyjesh sezonal.
2. Pagesa do të bëhet bazuar në vendimin nr. 38, datë 07.08.2023 të Këshillit Bashkiak "Për disa ndryshime në vendimin nr. 56 datë 24.11.2022 "Për miratimin e numrit të përgjithshëm dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2023".
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2024.
4. Ngarkohet drejtorja e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro



DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharremi

Drejtor i DBNJSHM

Andon Xani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 5674/prot.  
6

Himarë, më 12.12 2023

RELACION SQARUES

Lënda: Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Në mbështetje të nevojave që ka bashkia për mirëmbajtjen e territorit të saj gjatë sezonit turistik dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret gjatë stinëve të ngrohta të vitit, është menduar që të shtohet forca punëtore duke punësuar 12 punonjës sezonal mirëmbajtje dhe 5 roje pyjesh sezonal, me kontratë të përkohshme në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Gjithashtu për mbarëvajtjen e punës të institucioneve arsimore nën administrimin e Bashkisë Himarë, nevojitet të shtohen dhe 3 pozicione pune “Edukatore kopshti” me kontratë të përkohshme për të zëvendësuar edukatoret të cilat do të marrin lejen e lindjes, si dhe edukatore ndihmëse për fëmijët me aftësi ndryshe.

Për sa më sipër numri i punonjësve me kontratë pune të përkohshme, jashtë shtrukturës të bashkisë për vitin 2024, propozojmë të jetë 20 punonjës.

Për sa ju parashtruar në këtë relacion, bazuar në kërkesat e nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga ana e Këshillit Bashkiak.

KRYETARI I BASHKISË

DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharremi



Drejtore i DBNJSHM

Andon Xani